

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

**CILAT TË DREJTA TË MBROJTJES SOCIALE
MË TAKOJNË DHE SI TI REALIZOJË?**

Ndihma e garantuar minimale

Kushtet për marrjen e ndihmës	Çfarë përfshin kjo ndihmë
<p>Sigurohet për personin apo ekonominë familjare materialisht të pasiguar, të ekspozuar në rrezik social, të konstatuar në bazë të këqyrjes të drejtëpërdrejtë dhe dokumentacionit të Qendrës për punë sociale (QPS).</p> <p>Personi nuk mund të posedojë pronë dhe të drejta pronësore nga të cilat mund të mbahet.</p> <p>Përrjashtim nga kjo është nëse posedon pronë të tillë dhe të drejta, por për të njëjtat të ketë lidhur kontratë për mbajtje të përgjeshme deri me QPS.</p> <p>Për shfrytëzimin e kësaj të drejte, personi duhet të përmbush këto detyrime:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Rregullisht të paraqitet në agjencinë e punësimit si person i pa punë (detyrim që vlen për secilin person madhor të papunë në ekonominë familjare) përkundrazi NGM mund të ndërpritet▪ Të mos refuzojë angazhim të paarsyetuar të punës▪ Të bashkëpunojë me qendrën kompetente për punë sociale	<ul style="list-style-type: none">▪ Kompensim mujor në para që fillon nga 4.000 denarë në muaj, dhe rritet për çdo anëtarë të familjes, dhe person të mitur dhe madhor.▪ Subvencion për energji elektrike nga tetori në mars = shumë prej 1.000 denarë të harmonizuar në mënyrë përkatëse▪ Të drejtat për mbrojtje të fëmijëve në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve <p>* Shuma e kompensimit harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave, për janarin e vitit paraprak.</p>

Kompensimi për shkak të pengesës

Kushtet për marrjen e ndihmës	Çfarë përfshin kjo ndihmë
<p>Kjo e drejtë i takon personit me pengesë të rëndë apo të thellë intelektuale, apo pengesë më të rëndë trupore dhe personit plotësisht të verbër apo plotësisht të shurdhër.</p> <p>U ndahet personave të cilët u takojnë këtyre kategorive, kurse janë të moshës 26 dhe 65 vjet.</p> <p>Llojin dhe masën e pengesës e konstaton komisioni i shkallës të parë i përbërë nga tre mjek specialist me mendimin konziliar.</p>	<ul style="list-style-type: none">▪ Kompensim mujor prej 7.204,00 denarë për person me pengesë të rëndë apo të thellë intelektuale, me pengesë më të rëndë trupore dhe person plotësisht i verbër.▪ Kompensim mujor prej 4.117,00 denarë për personin plotësisht të verbër. <p>* Shuma e kompensimit harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave, për janarin e vitit paraprak.</p>

Shtesa za banim

Kushtet për marrjen e ndihmës	Çfarë përfshin kjo ndihmë
<p>Kjo e drejtë i jepet personin pa strehim dhe materialisht të pasiguarur që bën pjesë në një prej këtyre kategorive:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Shfrytëzues i NGM▪ Person që deri në moshën 18 vjeçare (e më së shumti deri në moshën 26 vjeçare nëse ka qënë nën kujdestari) ka patur status të fëmijës pa prindër dhe pa kujdes prindëror	<p>Për realizimin e të drejtës dhe lartesisë të shtesës:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Për shfrytëzues të NGM vendos këshilli i komunës dhe paguhet nga buxheti i komunës▪ Për personat me status të fëmijës pa prindër dhe kujdes prindëror paguhen mjete nga Buxheti i RMV

Kompensimi për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër

Kushtet për marrjen e ndihmës	Çfarë përfshin kjo ndihmë
<p>Kjo e drejtë i ndahet personit që ka mbushur të paktën 26 vjet të cilit i nevojitet ndihmë dhe kujdes sepse nuk mund të kryejë aktivitetet e ndryshme kryesore të jetës dhe i cili:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ është me pengesë intelektuale mesatare, të rëndë apo të thellë, ▪ është person me pengesë të rëndë dhe më të rëndë trupore, ▪ është person plotësisht i verbër, ose ▪ është person me ndryshime të përhershme në gjendjen shëndetësore. 	
<p>Kompensimi në para për ndihmë dhe kujdes i masës më të vogël i jepet personit me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ pengesë intelektuale mesatare dhe ▪ personit i cili për shkak të ndryshimit të përhershëm në gjendjen shëndetësore nuk mundet pa ndihmën e personit tjetër plotësisht të kryejë nevojat themelore jetësore. 	<p>Kompensim në para prej 3.959,00 denarë në pajtim me shpenzimet e jetës</p> <p>* Shuma e kompensimit harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave, për janarin e vitit paraprak.</p>
<p>Kompensim në para për ndihmë dhe kujdes i masës më të madhe i jepet personit me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pengesa intelektuale të rënda apo të thella . ▪ Pengesa trupore të rënda dhe më të rënda, ▪ Personit plotësisht të verbër, person me ndryshime të përhershme në gjendjen shëndetësore, që për këtë shkak nuk ka mundësi që vet të kryejë aktivitetet kryesore nga jeta e përditshme, e nuk mundet as me ndihmën e veglave ndihmëse ortopedike të lëviz në mënyrë të pavarur në banesë apo jashtë banesës, të ushqehet në mënyrë të pavarur, të vishet, të mirëmbajë higjienën personale, e as të kryejë nevojat kryesore fiziologjike. 	<p>Kompensim mujor prej 4.475,00 denarë në pajtim me shpenzimet e jetës</p> <p>* Shuma e kompensimit harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave, për janarin e vitit paraprak.</p>

Kompensim i përhershëm për prindin i cili është kujdesur për fëmijën me pengesa deri në moshën 26 vjeçare

Kushtet për marrjen e ndihmës	Çfarë përfshin kjo ndihmë
<p>Kjo e drejtë i takon prindit të fëmijës me pengesa i cili është kujdesur për fëmijën deri në moshën 25 vjeçare, i cili është i papunë dhe nuk shfrytëzon të drejtën e pensionit, pasi që të ketë mbushur 62 vjet (grua) respektivisht 64 vjet (burrë).</p> <p>Kjo e drejtë gjithashtu i ndahet edhe përkujdesësit i cili është përkujdesur për personin në familjen e tij të paktën pesëmbëdhjetë vjet, pasi që të mbush 62 vjet (grua), respektivisht 64 vjet (burrë), nëse është i papunë dhe nuk shfrytëzon të drejtën e pensionit sipas çfarëdo baze.</p>	<p>Kompensim mujor në para prej 8.000,00 denarë në pajtim me shpenzimet e jetës</p> <p>* Shuma e kompensimit harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave, për janarin e vitit paraprak.</p>

Kompensimi i rrogës për orarin e shkurtuar të punës për prindin që është kujdesur për fëmijën me pengesa dhe forma më të rënda të sëmundjeve kronike

Kushtet për marrjen e ndihmës	Çfarë përfshin kjo ndihmë
<p>E drejta në orar të shkurtuar të punës jepet për shkak të kujdesit për fëmijën me pengesa dhe forma më të rënda të sëmundjeve pavarësisht nga moshja e fëmijës. Realizohet për një prind nëse të dy prindët janë të punësuar, apo për prindin e vetëm të punësuar.</p>	<p>Kompensimi i rrogës është 50% nga rroga mesatare neto e prindit për vitin paraprak, por më së shumti deri në 50% nga rroga mesatare neto në vend për vitin paraprak.</p>

Ndihmë e njëfishtë në para dhe ndihmë në natyrë

Kushtet për marrjen e ndihmës	Çfarë përfshin kjo ndihmë
<p>Ndihmë e njëfishtë në para dhe ndihma në natyrë i ndahet:</p> <ul style="list-style-type: none"> Personit apo familjes e cila ndodhet në gjendje të rrezikut social, Personit dhe familjes për shkak të pësimit të fatkeqësisë natyrore apo epidemisë, Personit apo familjes në të cilën ndonjë prej anëtarëve është në mjekim më të gjatë në entin shëndetësorë. <p>Personat të cilët kanë marrë këtë ndihmë kanë afat prej 15 ditësh nga shfrytëzimi i mjeteve, e më së voni 3 muaj pas marrjes të ndihmës, të dorëzojnë dëshmi në QPS se mjetet janë shfrytëzuar për qëllimin që është theksuar në kërkesë.</p> <p>Ky detyrim nuk vlen për ndihmën e njëfishtë në para në lartësi prej 4.500,00 denarë.</p>	<p>Ndihmë e njëfishtë në para deri në 30.000,00 denarë i ndahet:</p> <ul style="list-style-type: none"> personit apo familjes në rrezik social, për shkak të pësimit të fatkeqësisë natyrore, epidemisë apo vdekjes të anëtarit të familjes, personit që ka nevojë për operacion apo mjekim më të gjatë jashtë shtetit dhe person me strehim të pasiguar shfrytëzues i NGM, i paaftë për punë , si ndihmë për sigurimin e strehimit të domosdoshëm. <p>Ndihmë të njëfishtë në para deri në 15.000,00 denarë i jepet:</p> <ul style="list-style-type: none"> personit-viktimë e dhunës në familje për sigurimin e mbrojtjes urgjente dhe përkujdesit. <p>Ndihmë juridike e njëfishtë në para deri 12.000,00 denarë i jepet:</p> <ul style="list-style-type: none"> personit apo familjes në rrezik social në rast të mjekimit më të gjatë në entin shëndetësorë; viktimës të dhunës në familje për realizimin e të drejtës në mbrojtje shëndetësore dhe trajtim mjekësor. <p>Ndihmë juridike e njëfishtë në para deri në 4.500 denarë për nevojat e personit apo familjes në rrezik social që nuk lë pasoja të përleshme, kurse është i domosdoshëm sigurimi social dhe material i personit.</p> <p>* Shuma e kompensimit harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave, për janarin e vitit paraprak.</p> <p>Ndihma e njëhershme intevuuese në para deri në 180.000,00 denarë për personin në moshë deri në 26 vjet, i cili deri në 18 vjet ka patur status të fëmijës pa prind dhe pa kujdes prindëror, apo ka qënë nën kujdestari edhe pas pushimit të kujdestarisë.</p>

KU MUND TË DREJTOHEM PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

- ✓ Shoqata dhe klinika juridike të cilat janë të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike falas
- ✓ Avokatë me kompetenca të fituara për dhënien e ndihmës juridike dytësore
- ✓ Në zyrat rajonale të Ministria e Drejtësisë (lista e kontakteve në shtojcë):

Njësitë rajonale	Telefonat
Berovë	071 205 324
Manastir	071 223 392
Makedonski Brod	071 223 075; 078 640 786
Vinicë	071 213 964
Vallandovë	071 213 925
Gjevgjeli	071 224 678; 071 216 267
Gostivar	071 223 180
Dibër	071 223 768
Delçevë	071 283 948
Demir Hisa	075 766 695
Kavadarë	075 659 855
Kërçovë	071 224 652
Koçanë	071 221 580
Kratovë	
Kriva Pallankë	071 224 580
Krushevë	071 227 808
Kumanovë	071 227 962

Njësitë rajonale	Telefonat
Negotinë	071 223 191
Ohër	071 221 908
Prilep	076 232 886
Probishtip	078 330 434
Radovish	070 261 310
Resnjë	071 221 246
Sveti Nikole	071 227 862
Strugë	071 223 015
Strumicë	071 224 526
Tetovë	071 227 893
Veles	
Shtip	071 221 484; 070 821 089
Karposh	071221381
Qendra	078 442 006
Kisella Vodë	071 224 104
Gazi Babë	071 213 798
Çairit	





INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

www.pravnapomos.mk

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Drejtësisë

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

